



Komuna e Klinës

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

10 Nr. 644-36182/22

Klinë, dt. 21.10.2022

Duke u mbështetur në Vendimin e Asamblesë Komunale për ndarje të Çmimit Vjetor të Artit Figurativ "ART KLINA", të dt.27.03.2015, Nr.06-2588/2015 si dhe në Rregulloren për mbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblime tjera, Nr.01-06-4414/2015 e datës 20.07.2015, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

PËR ÇMIMIN "ART KLINA" - 2022

- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë krijuesit e artit figurativ profesional me nga dy punime të realizuara në teknikat: vizatim, grafikë, pikturë dhe skulpturë.
- Punimet duhet të dorëzohen në Qendrën e Kulturës "Jehona e Dukagjinit" - Klinë, të zyrtarët për kulturë:

Taulant Berisha nr. 046 386 056, e-mail: taulant.berisha@rks-gov.net

Alban Gashi nr. 046 386 058, e-mail: alban.gashi@rks-gov.net

- Afati i dorëzimit të punimeve është deri më 15 nëntor 2022, nga dita e shpalljes në faqen zyrtare të komunës.
- Bashkë me punime, autorët duhet të dorëzojnë edhe një biografi.
- Punimet konkurruese duhet të jenë të përgatitura teknikisht dhe të kornizuara.
- Punimet e pranuar nga juria do të ekspozohen në Galerinë e Qendrës së Kulturës "Jehona e Dukagjinit" për nder të festës së 28 Nëntorit, hapja solemne e ekspozitës do të bëhet më datën 25.11.2022, ora 13:00.
- Juria profesionale me këtë rast vlerëson dhe jep çmimin "ART KLINA" – 2022 sipas përcaktimit në vijim;

1. Çmimi kryesor "Art Klina" - 300 €

2. Vendi dytë - 100 €

3. Vendi tretë - 100 €

Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport,

Fatjona GASHI

